

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® ViscoCrete®-400

ADITIV I FUQISHËM PËR SUPERPLASTIFIKIMIN E BETONIT DHE ME RUAJTJE TË KONSISTENCËS (SLUMP)



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® ViscoCrete®-400 është superplastifikues me performancë të lartë i gjeneratës së 3-të.

PËRDORIMET

Sika® ViscoCrete®-400 është posaçërisht i përshtatshëm për prodhim miksesh me konsistencë fillestare të lartë dhe ruajtje të konsistencës (slump). Përdoret për aplikimet e mëposhtme:

- Për beton të prodhuar në kantier me rezistenca përfundimtare të larta
- Për beton me kërkesë për reduktim të lartë të ujit
- Për kërkesa të shumta për beton cilësor
- Për beton me rezistencë të lartë
- Për aplikime ku nevojitet punueshmëri fillestare e lartë dhe ruajtje afatgjatë e saj
- Për betonim në temperatura të larta
- Për transport betoni në distanca të largëta
- Për beton të gatshëm për projektet me kërkesa të larta
- Për njësitë e prodhimit të betonit të gatshëm

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

Sika® ViscoCrete®-400 është superplastifikues i fuqishëm që ofron konsistencë fillestare të lartë dhe ruajtje të punueshmërisë. Me përdorimin e tij përftohen avantazhet e mëposhtme:

- Prodhim betoni me kategori fillestare konsistence të lartë
- Rrjedhshmëri e lartë betoni dhe ruajtje të zgjatur të saj
- Beton i punueshëm edhe në raste betonimi në temperatura të larta
- Lehtësi në menaxhin, hedhje dhe vibrim të betonit
- Prodhim betoni me dendësi të lartë dhe përshtueshmëri të reduktuar të ujit
- Tkurrje dhe zvarrje të reduktuara
- Ndërtime me paraqitje estetike të lartë dhe me rezistencë të zgjatur
- Sika® ViscoCrete®-400 nuk përmban klorure dhe është i përshtatshëm për beton të paranderur dhe të armuar.

MIRATIME / STANDARDE

Aditiv reduktues në shkallë të lartë i ujit / superplastifikues (& vonues i mpiksjes / reduktues në shkallë të lartë i ujit / superplastifikues) sipas EN 934.02:2009, T. 3.1 - 3.2 & T. 11.1 - 11.2, DoP 59921059 dhe mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

| | |
|-----------------------|--|
| Baza kimike | Solucion ujor polikarboksilatesh |
| Ambalazhi | IBC, fuçi 220kg, bidon 20 kg Furnizim rifuxho me porosi |
| Paraqitja / Ngjyra | Lëng, kafe e lehtë |
| Jetëgjatësia | 8 muaj nga data e prodhimit |
| Kushtet e magazinimit | Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +35°C. Të mbrohet nga rrezatimi drejtpërdrejtë diellor dhe ngrica. |

| | |
|--|-----------------------|
| Dendësia | ~1,04 kg/l (në +20°C) |
| Vlera e pH | 3,5 – 5,5 (në +20°C) |
| Përmbajtja totale e joneve të klorurit | Nuk ka (EN 934.01) |

TË DHËNA TEKNIKE

| | |
|------------------------|---|
| Udhëzime për betonimin | Duhet të zbatohen rregullat standarde të praktikës së betonimit për sa i përket prodhimit dhe hedhjes së betonit. Referohuni tek standardet përkatëse. Betoni i freskët duhet të trajtohet në mënyrë të përshtatshme. |
|------------------------|---|

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

| | |
|--------------------|---|
| Doza e rekomanduar | 0,4 – 2,0% për peshë çimentoje. |
| Kompatibiliteti | Sika® ViscoCrete®-400 mund të kombinohet me produktet e mëposhtme Sika: - seria Sika® Plastiment® - Sika® Plastocrete® N/ Sika®-1+ / Sika® WT-200 P - Sika® Visco I-100 - Sika-Aer® Fine - Sika® Ferrogard®-901 S - Sikafume® HR-D / Sikacrete® AR - akseleratorë betoni me spërkatje (shotcrete) Sika® Sigunit® Rekomandohet kryerja e testeve përpara kombinimit të produkteve. |
| Mënyra e aplikimit | Sika® ViscoCrete®-400 shtohet në ujin e përzierjes në fabrikë ose në betonieren e kantierit. |
| Kufizime | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përdorimi i Sika® ViscoCrete®-400 duhet bërë bazuar mbi një recetë të miratuar dhe duke testuar burimin lokal të materialeve. ▪ Sika® ViscoCrete®-400 nuk duhet të shtohet në çimento të thatë. ▪ Sika® ViscoCrete®-400 duhet të shtohet në ujin e përzierjes ose në fund të procesit të përzierjes. ▪ Përpara aplikimit duhet të kryhen teste përshtatshme. |

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sika® ViscoCrete®-400
Shkurt 2019, Botimi 01.01
021301011000000568

SikaViscoCrete-400-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf

